



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN



ИНСТИТУТ ЗА СТРАТЕШКО ИСТРАЖУВАЊЕ И ОБРАЗОВАЊЕ  
INSTITUTE FOR STRATEGIC RESEARCH AND EDUCATION



МАКЕДОНСКИ  
ЦЕНТАР ЗА  
МЕЃУНАРОДНА  
СОУПРАВНОСТ



# UDHËZUES PËR MBROJTJEN NGA KORRUPSIONI ZGJEDHOR TË POPULLATËS STUDENTORE



# UDHËZUES PËR MBROJTJEN NGA KORRUPSIONI ZGJEDHOR TË POPULLATËS STUDENTORE



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN



**Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim– IHSE**

**Për botuesin:** Dr. Misho Dokmanoviq

**Autor:** Dr. Darko Spasevski

**Përkthyes:** Urim kadriji

**Shtypi:** Stobi Trejd DOOEL Kočani

---

Udhëzuesi është përgatitur nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim– IHSE me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe në partneritet me MCMS. Përmbajtja dhe mendimet e shprehura në këtë udhëzues janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e MCMS, USAID-it ose Qeverisë së SHBA-së.

---

# HYRJE



Udhëzuesi për mbrojtjen nga korrupsioni zgjedhor ka për qëllim të mundësojë njohjen në detaje të popullatës studentore me të drejtat dhe detyrimet gjatë kontaktit dhe ekspozimit të tyre ndaj korrupsionit zgjedhor brenda statusit të tyre studentor, në nivel universitar, në kuadër të sistemit të akomodimit të studentëve dhe vakteve të organizuara studentore, në nivel të organizimit studentor, gjegjësisht në komunitetin e gjerë studentor. Në thelb, ky udhëzues duhet t'i ndihmojë studentëve të cilët do të gjenden në situatë si rezultat i ndikimit politik të kushtëzohen për shfrytëzimin e ndonjë të drejte që u takon në mënyrë legjitime.

Duke pasur parasysh faktin se studentët mund të ekspozohen ndaj korrupsionit zgjedhor në aspekte dhe në nivele të shumta, në kuadër të procesit të arsimit të lartë, ky udhëzues ofron këshilla dhe udhëzime për veprim në varësi të llojit dhe mënyrës së ekspozimit ndaj korrupsionit zgjedhor. Krahas korrupsionit zgjedhor, ky udhëzues jep edhe udhëzime për veprimin e denoncimit të sjelljeve joetike ose sjelljeve në një formë tjetër për veprim të paligjshëm (jo vetëm të korrupsionit), e cila ndikon në vullnetin zgjedhor të studentëve (përfitimet nëpërmjet vlerësimeve, etj.).

**Ky Udhëzues është përgaditur në kuadër të projektit „Aksioni për parandalimin e korrupsionit zgjedhor ndaj studentëve“ i cili implementohet nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim në kuadër të programit „Qytetarët kundër korrupsionit“ (QKK) financuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përmes Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID.**

Gjatë pregaditjes së këtij Udhëzuesi, nuk janë marrë parasysh gjetjet dhe njohuritë e marra nga Raporti i vlerësimit shtetëror të gjedjes për rezistencë ndaj korrupsionit zgjedhor midis popullatës studentore dhe dokumenti i krijimit të politikave i cili gjithashtu është përgaditur në kuadër të këtij projekti.

Në këtë drejtim, Udhëzuesi është i strukturuar në atë mënyrë që t'u ofrojë studentëve informacione të thjeshtësuara dhe relevante të cilët janë të ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor dhe ndikimeve të tjera nëpërmjet këtyre aspekteve:

**1.** Veprimi ndaj korrupsionit dhe veprimeve të kundërligjshme në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe Kodit Zgjedhor;

**2.** Veprimi ndaj korrupsionit dhe veprimit të kundërligjshëm në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë;

**3.** Veprimi ndaj korrupsionit dhe veprimeve të kundërligjshme në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe në kontekst të arsimit të lartë;

**4.** Roli dhe pozicioni i shërbimeve kompetente inspektuese në procesin e arsimit të lartë dhe

**5.** Veprimi dhe mbrojtja e studentëve përmes Avokatit të studentëve dhe formave të organizimit të studentëve.

# Veprimi ndaj korrupsionit dhe veprimi i kundërligjshëm në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe Kodin Zgjedhor

Organi kompetent për veprim ndaj ankesave për korrupsion dhe sjellje të paligjshme lidhur me parregullsitë që dalin nga shfrytëzimi i burimeve financare dhe publike në fushatat zgjedhore dhe financimi i partive politike dhe fushatave në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit<sup>1</sup>

(LPKKI) dhe Kodin Zgjedhor është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Sipas ligjeve të lartëpërmendura, ajo ka kompetencë të veprjë në rastet e korrupsionit zgjedhor dhe veprimeve të tjera të paligjshme të partive politike.

<sup>1</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019.

<sup>2</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 98/19, 42/20, 74/21, 215/21, 58/24 dhe 76/24.




## Për çfarë është përgjegjëse KSHPK?

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, KSHPK vepron në rast të kundërshtimit të parashtruar për mosrespektim të dispozitave të neneve 8-a dhe 8-b të Kodit Zgjedhor.


Neni 8- a përfshin ndalime siç janë:

- të fillojë ndërtimi me mjete nga buxheti ose nga fonde publike ose mjete të ndërmarrjeve publike dhe personave tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror të objekteve të reja të infrastrukturës si rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim, terrene sportive dhe objekte tjera; ose objekte për veprimtari shoqërore, shkolla, çerdhe dhe objekte tjera, përveç nëse për këtë qëllim paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, respektivisht bëhet fjalë për realizimin e programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin vijues dhe
- të kryhen pagesa të rrogave, pensione, ndihmës sociale ose pagesa tjera dhe kompensime materiale nga mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike që nuk janë mjete pagesore të



rregullta mujore, respektivisht të gjitha transferet njëvjeçare dhe pagesa të transfereve të njëhershme nga mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike, as të tjetërsohet kapitali shtetëror ose të nënshkruhen marrëveshje kolektive.

- të fillohet procedurë për punësimin e personave të rinj apo procedurë për pushimin e marrëdhënies së punës në institucione shtetërore dhe publike, kurse procedurat e filluara vihen në pezullim, përveç në rastet e punëve urgjente dhe të paprolongueshme.



**E rëndësishme:** ndalimi nga neni 8-a paragrafi (1) i referohet periudhës kohore nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes.

**Gjithashtu,** neni 8-a paragrafi (2) parashikon një sërë kufizimesh në periudhën prej 20 ditësh para fillimit të fushatës zgjedhore, deri në përfundimin e zgjedhjeve, veçanërisht në lidhje me përdorimin e paraqitjeve publike për promovimin e aktiviteteve të ndërtimit dhe vënies në punë të objekteve të financuara nga fondet publike.

**Gjithashtu,** neni 8-b i Kodit Zgjedhor e sanksionon shfrytëzimin e hapësirës së zyrës, pajisjes së zyrës dhe automjetet zyrtare të organeve shtetërore, përveç personave me të cilat kanë të bëjnë rregullat e veçanta për mbrojtjen e personalitetit.

**E rëndësishme:** Neni 8-b paragrafi 6 i Kodit Zgjedhor përfshinë ndalesën e përgjithshme për kryerjen dhe përpjekjen për të bërë presion dhe frikësim të votuesve apo anëtarëve të familjeve të tyre apo personave të afërt me to.

### Si vepron KSHPK?

- KSHPK vepron ndaj kundërshtit për mosrespektim të neneve 8-a dhe 8-b të Kodit Zgjedhor në mbledhje publike.
- Afati që KSHPK të veprojë për kundërshtimin nuk është më i gjatë se pesë ditë nga dita e paraqitjes së kundërshtimit.
- KSHPK është e detyruar që vendimin ta publikojë në ueb faqen e saj brenda 24 orëve nga dita e miratimit.
- Në seancë mund të marrë pjesë edhe personi që ka paraqitur kundërshtimin dhe ka të drejtë të prononcohet gojarisht.
- Kundër vendimit të KKPB-së, ankuesi ka të drejtë të ngrejë padi në Gjykatën Administrative brenda 24 orëve nga pranimi i vendimit.
- Gjykata administrative obligohet të marrë vendim brenda 48 orëve nga pranimi i padisë.


KSHPK vepron në përputhje me nenin 74-a të Kodit Zgjedhor dhe **në rast të kundërshtimit për mosrespektimin e dispozitave për financim të fushatës zgjedhore** të Kodit Zgjedhor.


### Si vepron KSHPK?

- KSHPK është i detyruar t'i hulumtojë konstatimet dhe të vendosë për kundërshtimin e parashtruar në afat prej 5 ditësh pas parashtrimit të kundërshtimit.
- KSHPK e dorëzon te personi kundër të cilit është parashtruar, në afat prej 24 orëve nga pranimi i kundërshtimit.
- Kundër vendimit të KSHPK lejohet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orëve nga pranimi i vendimit.

Gjykata Administrative detyrohet të miratojë vendim në afat prej 48 orëve nga pranimi i padisë.

KSHPK vepron për shkeljet në fushën e parandalimit të korrupsionit në politikë, në përputhje me kreun e katërt të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.





## Veprim më rast të ekzistimit të dyshimit për financim joligjor të partisë politike<sup>3</sup>:

- KSHPK me vetiniciativë ose me iniciativë nga organe shtetërore, parti politike ose shoqata dhe fondacione që punojnë në sferën e parandalimit të korrupsionit, sundimit të së drejtës ose menaxhimit të mirë.
- KSHPK, vendos me vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e financimit të një partie politike.
- KSHPK i dorëzon iniciativën partisë politike me një afat prej 15 ditësh për marrjen e vendimit për të.
- KSHPK është i obliguar në afat prej 60 ditësh ta kryejë procedurën ta informojë personin i cili ka ngritur iniciativë për hulumtimin dhe financimin e partive politike dhe ta informojë publikun për konstatimet nga procedura e ngritur.
- Nëse konstatohet se dyshimi është i bazuar, KSHPK inicion procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente.

<sup>3</sup> Neni 31 i LPKKI

## Veprim në rast të dyshimit për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore<sup>4</sup>:

- KSHPK vepron me vetiniciativë ose me kundërshtim nga organizatori i fushatës zgjedhore ose vëzhguesit e akredituar, ngre procedurë për përcaktimin e gjendjes faktike.
- KSHPK e dorëzon te personi kundër të cilit është parashtruar, në afat prej 24 orësh nga pranimi i kundërshtimit.
- Personi mund të prononcohet për konstatimet në kundërshtimin në afat prej tri ditësh nga dita e pranimi të tij.
- KSHPK ka për detyrë në mbledhje publike në afat jo më të gjatë se pesë ditë nga dita e pranimi të kundërshtimit t'i analizojë konstatimet dhe të veprojë për kundërshtimin.
- KSHPK e ka për detyrë në afat prej 24 orësh nga dita e caktimit të mbledhjes publike, vendimin ta publikojë në faqen e vet të internetit.
- parashtruesi i kundërshtimit, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i organizatorit të fushatës kundër të cilit është parashtruar kundërshtimi.
- Kundër vendimit të KKPBSë lejohet padia te Gjykata Administrative në afat prej 24 orësh nga marrja e vendimit, vendimin ta publikojë në faqen e vet të internetit.
- Gjykata Administrative e ka për detyrë të miratojë vendim në afat prej 48 orësh nga pranimi i padisë.

KSHPK vepron dhe kontrollon keqpërdorimin e mjeteve buxhetore në periudhën pas shpalljes së zgjedhjeve.

<sup>4</sup> Член 32 од ЗСКСИ.

## Si vepron KSHPK në këtë rast<sup>5</sup>?

- Në rast të ekzistimit të dyshimit për shkelje të dispozitave nga Kodi Zgjedhor për ndalim të përdorimit të mjeteve buxhetore, përkatësisht veprime të ndaluara të institucioneve publike nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, si dhe shkelje të dispozitave të këtij ligji që rregullojnë veprim të ndaluar nga çasti i miratimit të vendimit për shpallje të zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror me vetiniciativë ose pas kundërshtimit të parashtruar nga organizatori i fushatës zgjedhore, hap procedurë për konstatimin e gjendjes faktike.
- KSHPK e dorëzon te personi kundër të cilit është parashtruar në afat prej 24 orësh nga pranimi i kundërshtimit. Personi mund të deklarohet për konstatimet në kundërshtimin, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kundërshtimit.
- KSHPK është i detyruar që në mbledhje publike në afat jo më gjatë se pesë ditë nga dita e pranimit të kundërshtimit t'i analizojë konstatimet dhe të veprojë për kundërshtimin.
- KSHPK vendos për kundërshtimet në mbledhje publike dhe është i detyruar që në afat prej 24 orësh nga mbledhja e caktuar publike, vendimin ta publikojë në ueb faqen e vet.
- Në mbledhjen publike thirret dhe ka të drejtë të jetë i pranishëm parashtruesi i kundërshtimit, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i institucionit publik kundër të cilit është parashtruar kundërshtimi.
- Kundër vendimit të KSHPK lejohet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orësh nga marrja e vendimit. Gjykata Administrative është e detyruar që të miratojë vendim në afat prej 48 orësh nga pranimi i padisë.
- Kundër vendimit të KSHPK lejohet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orësh nga marrja e vendimit.
- Gjykata Administrative është e detyruar që të miratojë vendim në afat prej 48 orësh nga pranimi i padisë.
- Nëse konstatohet se dyshimet janë të bazuara, Komisioni Shtetëror është i detyruar që të iniciojë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

<sup>5</sup> Neni 33 i LPKKI.



### Si vepron KSHPK në këtë rast?<sup>6</sup>

- KSHPK vepron nëse ekziston dyshimi se Partia politike ose kandidati në zgjedhje nuk guxojnë të mbledhin dhe shfrytëzojnë mjete të kundërligjshme ose nga burime anonime.
- KSHPK është e autorizuar të kërkojë nga organet kompetente të kryejnë kontroll të burimit të mjeteve dhe të ai të dorëzojnë raport të hollësishëm për shfrytëzimin e mjeteve.

Nëse konstatohet se dyshimet janë të bazuara, KSHPK në afat prej shtatë ditëve nga dita e përcaktimit të dyshimit të bazuar, inicon procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente.

KSHPK vepron edhe në rast të dhënies së ryshfetit të zgjedhësve.

<sup>6</sup> Neni 35 i LPKKI.

### Si vepron KSHPK në këtë rast?<sup>7</sup>

- Nëse Komisioni Shtetëror kupton ose ka baza për dyshim për ryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit, respektivisht për dhënien ose premtimin e dhuratës, ose ndonjë përfitim tjetër për vete ose për tjetër, zgjedhësit gjatë zgjedhjeve ose votimit në referendum, që të votojë ose të mos votojë, ose të votojë për kandidat të caktuar ose vendim të caktuar, për atë pa prolongim do ta njoftojë prokurorin publik kompetent.
- Prokurori publik në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (2) të këtij neni e njofton Komisionin Shtetëror për masat e marra dhe aktivitetet në suaza të kompetencave të veta.

<sup>7</sup> Neni 37 i LPKKI.

# Veprimi ndaj korrupsionit dhe veprimi i kundërligjshëm në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë

Studenti i ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor në kuadër të procesit të arsimit të lartë, mund të shfrytëzojë të drejtën e përcaktuar me nenin 107 të Ligjit për arsimin e lartë (në tekstin e mëtejshëm:LAL) dhe t'i drejtohet për mbrojtje personit të autorizuar për pranimin e kallëzimeve për korrupsion në universitet.

Bëhet fjalë për personin të përcaktuar nga Senati i universitetit, dhe i zgjedhur nga profesorët e rregullt të universitetit.

Sipas këtij modeli/opsioni kallëzimi i korrupsionit kryhet me gojë në procesverbal ose në formë të shkruar.

Kallëzimi mund të jetë gjithashtu anonim.

<sup>8</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 178/21 dhe 58/24.

Studenti që ka denoncuar Kallëzimin ndaj korrupsionit zgjedhor në përputhje me nenin 107 të LAL, ka të drejtë ta informojë denoncuesin i cili është i njohur për masat e marra në lidhje me denoncimin pa prolongim, kurse më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kallëzimit.

Çdo institucion i arsimit të lartë në përputhje me nenin 107 paragrafit 4 të LAL, puna dhe kompensimi i personit të autorizuar për pranimin të denoncimeve për korrupsion rregullohen me akt të përgjithshëm që e miraton Senati i Universitetit.

# Veprimi ndaj korrupsionit dhe veprimi i kundërligjshëm në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe në kontekst të arsimit të lartë

Ligji për mbrojtjen e denoncuesve rregullon denoncimin e korrupsionit dhe veprimeve të tjera të paligjshme dhe joetike.

Studenti paraqitet si denoncues në përputhje me nenin 2 paragrafin 3 paragrafi 6 të Ligjit për mbrojtjen e

denoncuesve (në tekstin e mëtejshëm: LMD), si person i cili shfrytëzon ose ka shfrytëzuar shërbimet në institucionin, përkatësisht personin juridik në sektorin publik dhe privat ku denoncon.

**E rëndësishme: denoncimi mund të bëhet, përveç institucioneve të arsimit të lartë publik (shtetëror) dhe konvikteve studentore shtetërore, si dhe në institucionet e arsimit të lartë privat dhe konviktet private studentore.**


**Regjistrimi i studentit do të kryhet në përputhje me nenin 4 të LMD dhe do të trajtohet si denoncimi i mbrojtur i brendshëm.**

**E rëndësishme: denoncimi mund të jetë gjithashtu anonim.**

**Procedura e denoncimit është rregulluar me Rregulloren për denoncimin e brendshëm të mbrojtur në institucionet në sektorin publik (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore) botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, nr. 46/2016.**

<sup>9</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 196/15 dhe 35/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 257/20.

<sup>10</sup> Neni 3 (1) i PPE.



**Hapi 1:** denoncimi i parashtrohet personit të autorizuar për praninë të denoncimit nga denoncuesi ose udhëheqësi i institucionit nëse nuk ka të caktuar person të tillë. Të dhënat e personit të autorizuar janë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të institucionit.

**Hapi 2:** Personi i autorizuar e vërteton dhe e regjistron kërkesën në libër, dhe nëse denoncimi është pranuar gojarisht, përpilon procesverbal.

**Hapi 3:** Personi i autorizuar e shqyrton denoncimin, e studion përmbajtjen e tij dhe, në varësi të gjetjeve, mund të vendosë nëse denoncimi është i pabazuar, ose të përcaktojë se denoncimi është i bazuar, me çrast sjell konkluzione për veprime të mëtejshme lidhur me denoncimin që ka të bëjë me kompetencën, gjegjësisht moskompetencën e

institucionit ku është emëruar dhe masat e nevojshme për të vepruar sipas denoncimit.

**Hapi 4:** Në çdo rast, për veprimet e ndërmarra nga hapi 3 i njoftohet denoncuesi nëse është i niohur.

**Hapi 5:** Nëse për veprim është kompetent institucioni tjetër është personi i autorizuar është i detyruar ta dorëzojë denoncimin dhe t'ia përcjellë institucionit kompetent jo më vonë se tetë ditë nga dita e pranimit.

**Hapi 6:** Nëse personi i autorizuar në institucion vlerëson se lënda e denoncimit është vepër penale, denoncimin ia përcjell organeve kompetente shtetërore për veprim të veprave penale.

**Hapi 7:** Për përcjelljen e denoncimit nga hapi 6, personi i autorizuar e

<sup>11</sup> Neni 2 i Rregullores.

<sup>12</sup> Neni 6 i Rregullores.

<sup>13</sup> Neni 8 dhe 9 i Rregullores.

<sup>14</sup> Neni 11 (1) i Rregullores.

<sup>15</sup> Neni 11 (2) i Rregullores.

informon njëkohësisht denoncuesin, nëse është i njohur.


**Hapi 8:** Nëse personi i autorizuar konstaton se institucioni të cilit i është dërguar denoncimi nga denoncuesi është kompetent për veprim, ai ia përcjell denoncimin personit kompetent në institucionin përgjegjës për veprimin në atë

fushë. Denoncuesi mund të kërkojë të njoftohet për veprimet e ndërmarra dhe mund të kërkojë shikim në shkresat e lëndës. Personi i autorizuar e informon denoncuesin për rezultatin e procedurës për rastin e ngritur pas denoncimit, nëse është i njohur.

**Shënim:** kur studenti është i ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor brenda procesit të arsimit të lartë, studenti mund të përdorë ose mekanizmat e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve ose mundësinë e denoncimit të korrupsionit në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë ose duke kontaktuar avokatin e studentëve. Megjithatë, nëse studenti është i ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor jashtë institucionit të

arsimit të lartë, si konviktet e studentëve dhe të ngjashme, atëherë studenti mund të përdorë mekanizmat e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, ose duke iu drejtuar KSHPK nëse bëhet fjalë për shkelje të Kodit Zgjedhor ose Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

<sup>16</sup> Neni 11 (3) i Rregullores.



# Улогата и положбата на надлежните инспекциски служби во високообразовниот процес



Në kushte dhe rrethana të caktuara, studenti mund t'i drejtohet edhe Inspeksionit Arsivor në përputhje me Ligjin për inspeksionin arsimor<sup>17</sup> (në tekstin e mëtejme: LIA).

Në këtë segment është erëndësishme të theksohet se një student mund t'i drejtohet inspektimit arsimor me kërkesë për inspektim nëse mendon se është i ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor dhe se:

- në institucionet e arsimit të lartë ku mbikëqyret zbatimin i ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë, për çështje të përcaktuara me ligj, dhe
- - në konviktet e studentëve ku bëhet mbikëqyrja mbi zbatimin e ligjeve dhe dispozitave dhe akteve të tjera që rregullojnë konviktet e studentëve.<sup>18</sup>

<sup>17</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/05, 81/08, 148/09, 57/10, 51/11, 24/13, 137/13, 164/13, 41/14, 33/15, 145/15, 30/16 dhe 64/ 18.

<sup>18</sup> Neni 2 i Ligjit për inspeksionin arsimor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/05, 81/08, 148/09, 57/10, 51/11, 24/13, 137/13, 164/13, 41/14, 33/15, 145/15, 30/16 dhe 4/ 18)



Kur flitet konkretisht, studenti që denoncon duhet të ketë parasysh se Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në përputhje me nenin 9, është veçanërisht kompetent për mbikëqyrjen e:

- ekzistimin e kushteve për kryerjen e veprimtarisë në institucionet edukativo-arsimore, në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore, në konviktet e nxënësve dhe të studentëve;
- kushtet e posaçme për zgjedhjen e arsimtarëve, zgjedhjen e bashkëpunëtorëve dhe edukatorëve profesionalë;
- realizimin e konkursit për regjistrimin e nxënësve dhe të studentëve dhe të konkursit për vendosjen e nxënësve dhe studentëve në konviktet e nxënësve dhe të studentëve;
- realizimin e programeve eksperimentale në institucionet edukativo-arsimore;

- zbatimin e rregullativës ligjore në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore dhe
- zbatimin e rregullativës ligjore nga fusha e ndalimit dhe pengimit të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar në institucionet edukativo-arsimore, në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet shkencore.

Mbikëqyrja e cila kryet nga inspektori shtetëror i arsimit mund të jetë: 1) evuluimi integral i institucioneve arsimore, 2) mbikëqyrje e rregullt inspektuese, 3) mbikëqyrje e jashtëzakonshme inspektuese dhe 4) mbikëqyrje kontrolluese.

**E RËNDËSISHME: Në bazë të nenit 21, mbikëqyrja e jashtëzakonshme bëhet në bazë të iniciativës nga ana e nxënësve, studentëve, prindërve, Këshillit të prindërve, të punësuarve në institucionin edukativo-arsimor dhe nga qytetarë të tjerë.**

# Veprimi dhe mbrojtja e studentëve përmes Avokatit të popullit të studentëve dhe formave të organizimit të studentëve

Studenti i ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor brenda institucionit të arsimit të lartë mund të ushtrojë të drejtat dhe mbrojtjen e tij para Avokatit të studentëve në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë<sup>19</sup>.


Procedura për mbrojtjen e të drejtave të studentit në rast të ekspozimit ndaj korrupsionit zgjedhor para Avokatit të studentëve rregullohet me nenin 32 të ligjit.

Studenti që mendon se i është shkelur e drejta, për shkak të ekspozimit ndaj korrupsionit zgjedhor në procesin arsimor, i parashtrohet parashtrësë Avokatit të studentëve.

Avokati i studentëve, nëse sheh se të drejtat e studentëve kërcënohen për shkak të ekspozimit ndaj korrupsionit zgjedhor brenda procesit arsimor, mund të veprjë edhe me iniciativën e tij.

<sup>19</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 178/21 dhe 58/24.





ndaj korrupsionit zgjedhor brenda procesit arsimor, mund të veprojë edhe me iniciativën e tij.

**E RËNDËSISHME:** shkelja duhet të kryhet nga autoritetet e Universitetit ose nga një anëtar tjetër i komunitetit akademik të Universitetit. Në bazë të nenit 5 paragrafit 1 të LAL, Bashkësinë akademike e përbëjnë personat e përzgjedhur në tituj mësimor-shkencor, shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe tituj bashkëpunëtorë dhe studentët. Kjo do të thotë se Ligji parashikon mbrojtje për studentin jo vetëm kur institucioni i arsimit të lartë cenon të drejtën e tij, por edhe kur bëhet nga profesori apo asistenti.

Parashtresa, gjegjësisht nisma, i dorëzohet autoriteteve të institucionit të arsimit të lartë, të cilat janë të detyruar të veprojnë sipas udhëzimeve të avokatit të studentëve.

**E RËNDËSISHME:** kur cenohet e drejta e studentit në nivel fakulteti, studenti i drejtohet zëvendës avokatit të studentëve. Krahas kësaj procedure, e cila është përcaktuar zyrtarisht në nenin 32 të Ligjit për arsimin e lartë, studenti mund të kërkojë mbrojtje nga korrupsioni zgjedhor në procesin e arsimit të lartë dhe nëpërmjet formave të organizimit studentor, konkretisht: asamblesë studentore të fakultetit dhe asamblesë studentore universitare.

**E RËNDËSISHME:** studenti në ushtrimin e të drejtave të tij mund t'u drejtohet edhe studentëve anëtarë të organeve dhe organeve të universitetit dhe fakulteteve.